


BËJMË NJË MITROVICË MË TË MIRË

PUNËTORIA E VIZIONIMIT – KUALITETI I MJEDISIT JETËSOR NE MITROVICË

Punëtorja ishte përqendruar në ide për të përmirësuar kushtet jetësore në Mitrovicë (Jug dhe Veri).

Nga 11 janari deri me 15 janar, një punëtori kreative dhe intensive u mbajt në Shkup – IRJ e Maqedonisë, që përfshinte shoqërinë civile dhe planifikues profesional nga jugu dhe veriu në vizionimin e çështjeve dhe ideve për të përmirësuar kualitetin e mjedisit jetësor në Mitrovicë.

Kjo punëtori u organizua nga UN-Habitat në Kosovë në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Shoqërisë Civile, radios Kontakt Plus, Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë dhe Radio-Tv Mitrovica. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave të medieve



Harta e Mitrovicës – Gjilpërat tregojnë vendet në kujtesën e pjesëmarrësve.

dhe qytetarë të Veriut dhe Jugut, të mobilizuar nga organizimi i dyanshëm i shoqërisë civile dhe organizatave të medieve (2x10 qytetarë + 2 përfaqësues për organizator). Gjithashtu pjesë morën edhe 6 planifikues urban profesional të Jugut dhe Veriut të Mitrovicës, sikurse edhe 6 pjesëtarë të stafit të UN-Habitat.



Shkupi qendror në natë



Pjesëmarrës gjatë paraqitjes së punëtorisë.

***Kriza Ekonomike
dhe kualiteti i
dobët i jetës që po
vuajnë njerëzit në
dy pjesët e qytetit
ishin pikat
fillestare për idetë
dhe dialogët
ndërmjet dy
komuniteteve.***

QËLLIMI DHE ARRITJA

Qëllimi i punëtorisë ishte të eksplorojë në një mjedis jo-zyrtar çështjet dhe veprimet e mundshme për të përmirësuar kualitetin e mjedisit jetësor të gjithë qytetarëve të Mitrovicës. Kriza ekonomike dhe kualiteti i dobët i jetës që njerëzit po vuajnë si në Veri ashtu edhe në Jug ishin pikat fillestare për idetë dhe dialogjet ndërmjet dy komuniteteve .

Duke shprehur shqetësimet dhe parapëlqimet e tyre, njerëz nga dy pjesët e qytetit dalluan çështjet e përbashkëta dhe punuan së bashku për të gjetur zgjidhjet nga



Aktivitetet e punëtorisë duke u shpjeguar



OSBE siguroi transport

të cilat do përfitonin të gjithë. Punëtorja arriti angazhimin dhe fuqizimin e shoqërisë civile dhe organizatave të medieve në Jug dhe Veri, gjithashtu edhe forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe planifikuesve profesionale të Mitrovicës Jugore dhe asaj Veriore.



MULTIVIZIONIMI

Duke përdorur metodën e multi-vizionimit të gjitha idetë e mundshme u shqyrtuan në një mënyrë shumë kreative. Multi-vizionimi i mjedisit jetësor të Mitrovicës do të thotë që të gjithë ishin të lirë të paraqisnin vizionin dhe idetë e tyre, pa pasur nevojë që idetë e tyre t'i integronin në një vizion të vetëm. Edhe pse kjo qasje hap rrugë për vizione të ndryshme të Jugut dhe Veriut,, synimi ishte që të



diskutoheshin haptas elementet e përbashkëta dhe kundërshtuese të ideve dhe vizioneve të zhvilluara, duke rezultuar në një Deklaratë të Vizionit të Përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të Mitrovicës në afat të shkurtër (2012) dhe afat të gjatë (2022).

OBJEKTIVAT



Duke punuar sëbashku

*Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave civile shoqërore të Mitrovicës Jugore dhe Veriore.

*Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave civile shoqërore dhe profesionale. Objektivat e punëtorisë janë paraqitur si vijon:

*Fuqizimi i shoqërisë civile dhe mediave lokale në planifikimin hapësinor përfshirës dhe komunitar për të përmirësuar kushtet hapësinore të kualitetit të jetës në Mitrovicën Jugore dhe Veriore.



Duke thyer akullin me topin rozë

“Fuqizimi i shoqërisë civile dhe mediave lokale”

“Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit”

METODOLOGJIA

Punëtorija përdori shumë mënyra duke përfshirë: një seancë tregimesh, seancë trajnimi, grupe punuese paralele, diskutime plenare, seanca për të ndarë përvojat, aktivitete shoqëruese dhe prezetime multi-media.

Seancat ishin në gjendje të fillonin me grupe të përziera punuese dhe një grup të ndarë planifikuesish, pastaj të mbarojë me një diskutim plenar.



Seancat e tregimit, duke veqar vendet që zenë një vend të rëndësishëm në kujtesën e

TREGIMET

Seanca e tregimeve ishte një udhëtim virtual, një paraqitje nëpërmjet një fjalimi 5 minutash duke përshkruar një vend ose ngjarje të parapëlqyer. Kjo seancë pruri një shpirt në punëtori duke treguar tregime dhe duke shpalosur kujtime të mira nga fëmijëria. Kjo seance japi një mundësi për pjesëmarrësit të tregojnë se sa e adhurojnë qytetin e tyre: qyteti me pozicionin më të mirë gjeografik, lokacioni dhe lumenjtë që të gjitha qytetet tjera në Kosovë do ëndërronin, qyteti më një lindje të mrekullueshme të diellit.



Pjesëmarrësit vendosin shënime në hartë lidhur me vendet e preferuara



HARTA MENTALE



Duke vendosur shënime në hartën e Mitrovicës duke veçuar vendet në kujtesën e tyre. Kjo çoi në krijimin e hartës mentale



Pjesëmarrësit krijojnë një hartë mentale të Mitrovicës që bashkon kujtimet dhe vendet e veçanta nga seanca e tregimeve



“Harta Mentale” e Mitrovicës

AKULLTHYESIT

Çdo mëngjes, një seancë e shkurtër ishte dedikuar për t’u çlodhur dhe për pak argëtim për të thyer akullin dhe përgatitur për ditën.



Aktivitetet “akullthyesë” ishin një mënyrë e mirë për të filluar ditën..

ZGJEDHJA E TEMAVE

Çështjet me më shumë rëndësi për Mitrovicën:

1. Zhvillim i Ekonomik

2. Kualiteti Mjedisor

3. Lëvizshmëria dhe Infrastruktura

4. Paisjet dhe shërbimet publike


5. Kualiteti urban dhe ndjenja e Identitetit

Pjesëmarrësit ishin ndarë në 5 grupe punuese të përziera. Çdo grup diskutoi çështjet dhe temat me më shumë rëndësi për Mitrovicën tani dhe në të ardhmen .





Në diskutimet plenare, çështjet u paraqitën dhe aty u dalluan shumë tema të përbashkëta. Pastaj grupi veçoi 5 çështjet më të rëndësishme. Këto çështje pastaj udhëhoqën pjesët e mbetura të seancave.



Grupet diskutojnë përzgjedhjen e temave me më shumë rëndësi për Mitrovicën.



Prioriteti për disa nga grupet







MITROVICA TANI— ANALIZA SWOT

Analiza SWOT (Fuqitë, Dobësitë, Kërcënimet dhe Mundësitë) ishte bërë nga të gjitha 5 grupet në një mënyrë më të thjeshtë për një nga këto tema specifike të zgjedhura.

Dobësitë dhe Mundësitë

Çdo grup bëri një listë problemesh dhe mundësish lidhur me temën e grupit.



JAVLLI, SERVIS (VODA I STRUJJA)

PROBLEH JAVLLOG SERVISA, PËRE SIEGA VODE I STRUJE, HOJE BITI REJËJI: (IZGRADNOM VODOM KANALOM ILLI TRAJIRENEN RAPHËQËTË TUMITË STABILICE U JIP-AR I ELIMINISIAJËM QUBITARA VODE U SALLI HREËI (SËRE STARE LI PUTARJE CEVI).

PROBLEH SA STRUJËM HATËTËJE USLED OGRANICELOG KAPACITETA ELEKTRIKE U OPIJËCU. ODEAVAJE TË TËTËJE KANALIZACI DHE HREËE I QËNO TRAJIRENË JE VËRILLO ZËRËG OCUVANJA ZIVOTHE SREDIHEE. REJËCËJE ZA OVIM PROBLEH JE IZGRADNJA KANALIZACILOG KOLEKTORA.

- SËLLE - PROBLEH OGRANICELOG TROSTORA REJËTI IZGRADNOM VODIË OBJEKATA I ADERUAT-HIH OPRANAJOM ISTIH. ISTO VAZI I ZA OPRANJOM STA.

- PËRZËVI - ZHETIATËJËM REPRANHO TË DËGJËTËH OBJEKTA, DËRËJA JE IIA TROSTORU DËI JE SËRËSËJA JËR. VODE PRETVORITI U FAKËRËJE.

- LIRBANI TRAJIË - SUHORUJË LËGLED GRADA, JËTËHJËTAVKHO SE MOËRE RESITI TRAVILANUHI I LIMERELIOM LIPOTREBOM BOJA. VEOMA PËRËJËTAVKHO, Y ULAGANJËM RANIE SIAËJE GRADNIA.

REZAVAJËJE PROBLEMA JAVLLOG SERVISA JE TAK OPRANJE I ORGANIA IIA ZIVOTU TRAJËNË (KUIHJËTAVKHO).

- IDENTIFIKIMI I OBJEKTEVE -

- 1) MINIERA, FLOTACIONI, DHE SHKRITORDJA
- 2) RAJONI I SHALËS, KALAJA E ZIVEÇANIT DHE BRIGJET E LUMIT I BËR.
- 3) TREGU I BAGËTIVE DHE FABRIKA E TËGJULLAVE NË ZAITKOVË.



Planifikuesit punojnë në një FDKM vizuale të temave të integruara (gjithë të 5-tat).

MITROVICA TANI—ANALIZA SWOT

Rezultatet e analizës FDKM u prezantuan në një seancë plenare




Dobësitë e veçara ishin:

- ndotja e mjedisit ,
- ndotja e bregut të lumenjve,
- mungesa e shërbimeve publike dhe deponive,
- mosveprimi i Trepçës,
- Infrastruktura e ulët,
- mosveprimi i bujqesise,

- Institucionet bankare, dhe
- kapaciteti i ulët i stabilimenteve rekreative

Mundësitë e përfshira:

- përmirësimi i rrjetit të rrugëve,
- lidhja internacionale hekurudhore
- sistemi i ujësjesit



- industria dhe minierat
- rekreacioni në brigjet e lumenjeve
- turizmi në verë dhe dimër
- bujqësia
- revitalizimi i disa pjesëve të Trepçës
- investime të reja në infrastrukturës që do të kontribuonte në përmirësimin e turizmit
- bujqësia dhe blegtoria
- ndërtimi i kapacitetit arsimues

MITROVICA NESER – VIZIONI

Gjate vazhdimet te punëtorise , grupet ishin të etura të punonin në vizionin e qytetit dhe sloganin. Idetë nga analiza SWOT ishin shpalosur në ushtrimet e vizionimit.

çdo grup punoi në përcaktimin e vizionit, sloganit dhe logos për një Mitrovicë të së ardhmes bazuar në temën e grupit.

çdo grup paraqiti vizionet e tyre para grupit penlar.






Një nga vizionet:

**”Qiej plot zogj,
lumenj plot
peshq, fusha plot
gjelbërim”.**




Varesisht nga tema e grupit, deklaratat dhe sloganet e grupit ishin të ndryshme si p.sh. : për qytetin e lumit – “qiej plot zogj, lumenj plot peshq, fusha plot gjelbërim: dhe për qytetin e Kristalit – “ aty ku kristalet dhe lumenjtë takojnë traditën dhe kulturën”, e cila u zgjodh si slogan më i mirë.



Prezantimi i deklaratave të vizionit dhe sloganëve u bënë nga secili grup.

MITROVICA NESER – DIZAJNIMI I VIZIONIT



Nga fjalët tek fotografitë— vizualizimi i aktiviteteve të ardhme.

Mitrovica:

Qyteti Kristal,

Qyteti i Lumit,

Qyteti Mobil,

Qyteti Publik,

Qyteti i Kulturës,



Qyteti i Thesarit.



Ide të nga ushtrimet e vizionimit u transferuan tek mediumet vizuale të hartave jo-zyrtare tematike, të emëruara figurativisht si :

1. Qyteti i Kristalit - Ekonomi
2. Qyteti i Lumit – Mjedis
3. Qyteti Mobil – Trafik
4. Qyteti publik – Shërbime Publike
5. Qyteti i Kulturës - Kulturë
6. Qyteti i thesarit – (grupi i planifikuesve) përfshinte gjitha temat.

Grupet krijuan piktura të bukura dhe harta shumë-ngjyrëshe.



Kur idetë u transferuan në harta jo-zyrtare, shënime me ngjyra të ndryshme u përdorën për të treguar se çfarë aktiviteti ishte, afat-shkurtër, mesëm (5 vjet) ose afat-gjatë (15 vjet). Ata gjithashtu treguan projektet që do të mund të ndërmerren nga grupet e komuniteteve, administrata lokale dhe agjencitë qendrore qeverisëse.


MITROVICA NESER – DIZAJNIMI I VIZIONIT

Sugjerimet për projekte:

Revitalizimi industrial,

Krijimi i qosheve të reja të gjelbra në qendër dhe mbjellja e 3 drunjëve për banorë.

Projektet afatshkurtër dhe afatmesme (5 vjet) përfshinë: Revitalizimi i zonave industriale dhe të gjelbra, industritë e pastra dhe rekonstruktimet e ndryshme, sistem i ri i ujërave të zeza, revitalizimi i brigjeve të lumenjve, krijimi i rripave të ri të gjelbër në qendër, mbjellja e drunjëve (3 drunj për banorë), Zhvillim turistik (Liqeni Gazivoda, Kodrat e Shalës), përmirësimi i rrugëve ekzis-



tuese, implementimi i sistemit parkues, sistemi hekurudhor dhe i autobusit, vend-parkim me treg,

Shërbime bazë si shkolla të reja dhe foshnjore, përmirësimi zonave rurale, organizimi i ngjarjeve kulturore.

Projektet afatgjatë (15 vjet) përmbajnë: Tren të shpejtësisë së madhe, autostrada të përmirësuara dhe të reja, krijimi i një biblioteke të përbashkët afër pallatit të kulturës dhe muzeut, sistemi i shtigjeve për biçikletave.

Të pakta ishin pikat kundërshtuese ndërmjet grupeve. Pikat kryesore kundërshtuese ishin lokacionet e industrive ndotëse dhe vendndodhja e industrive të mëdha brenda qytetit.



Shënimet e vendosura paraqesin aktivitetet e ardhshme dhe investimet – me ngjyrë rozë ato afatshkurte dhe kosto të ulët, me ngjyrë të verdhë për ato afatmesme (5 vjet) dhe me ngjyrë të kaltër për projekte afatgjata.

MITROVICA NESER— PREZANTIMI FINAL



Prezantimi final i punëtorisë u mbajt në qendrën për Bashkëpunim Internacional në Maqedoni (MCIC) dhe hartat vizuale, analizat SWOT, pikat e konsensusit dhe konfliktit, vizionet dhe sloganet ishin prezantuar ndaj gjithë grupit ashtu sikur ndaj përfaqësuesit të SIDA-s, OSBE-së dhe MCIC-së të cilët kanë marrë pjesë në këtë ngjarje.




POSTSCRIPT

Në çfarëdo situatë si kjo, gjithmonë ekziston një shkallë e politizimit, megjithë që ka ekzistuar një përpjekje e përbashkët gjatë kësaj punëtorie për t'ju përmbytur udhëzimeve të deklaruara dhe të miratuara të cilat kanë përfshirë përjashtimin e diskutimeve lidhur me gjendjen politike dhe të merren vetem me analizimin e opsioneve për përmirësimin e mjedisit jetësor në Mitrovicë. Punëtorinë nuk kishte të bënte në asnjë mënyrë me procesin e planit zhvillimor komunal dhe urban (PZhK/PZhU), ndërsa UN HABITAT-i nuk është i përfshirë drejtpërsëdrejti në këtë proces në Mitrovicë.

Sido që të jetë, është theksuar se në përgjithësi ekziston mungesë e transparencës nga ana e Komunes së Mitrovicës, ku pjesëmarrësit nga të dyja anët e qytetit shprehnin mosdijeni lidhur me procesin e PZhK/PZhU dhe lidhur me angazhimin e kompanisë për këtë qëllim. Pjesëmarrësit nga pjesa veriore kanë kërkuar që raportit t'i shtohet një pashënim ku nënvizohet pakënaqësia e tyre me mungesën e konsultimit dhe përfshirjes së qytetarëve dhe profesionistëve nga pjesa veriore. Për më tepër, ata kanë kërkuar sqarimin dhe zgjidhjen e këtyre çështjeve në përputhje me interesin më të mirë të të gjitha palëve në fjalë dhe kanë paralajmëruar se nuk do të marrin pjesë në proceset e mëtejme të planifikimit hapsinor, derisa të formohet komuna e re në Mitrovicën Veriore.

Pas kësaj kërkesë, UN HABITAT-i ka ndihmuar në marrjen e informacioneve nga Komuna e Mitrovicës lidhur me procesin e planifikimit dhe projektet e PZhK/PZhU dhe këto informacione i janë përcjellur partnerëve të shoqërisë civile dhe pjesëmarrësve nga të dyja pjesët e qytetit. UN HABITAT-i është i përkushtuar që të vazhdojë të punojë me komunitetet dhe profesionistët nga të dyja anët e Mitrovicës, për t'u fokusuar në çështjet konkrete si lëvizshmëria dhe ndërtimi i kapaciteteve dhe për të kërkuar rrugën më të mirë për të ecur përpara në frymën e dinamikës së re të krijuar me pakon e Ahtisaarit.

MITROVICA — DEKLARATA E INTEGRUAR E VIZIONIT DHE SLOGANI




Slogani i zgjedhur për Mitrovicën

Puna dhe rezultatet nga kjo punëtori do jenë pjesë e një procesi vazhdues.

Hapi tjetër do jetë një debat i gjerë publik ku këto ide do diskutohen nga një pjesë më e madhe e komunitetit.



Zgjidhjet për logon e qytetit



Vizioni i sugjeruar për Mitrovicën



UN-HABITAT
Municipal Spatial Planning
Support Program



FALËNDERIMET

Programi i Mbeshtetjes se Planifikimit Hapesinor i implementuar nga UN -HABITAT-i financohet nga Sida dhe mbeshtetet nga Institucionet e Perkoheshme Veteqeverisese.

Punëtorja është mbështetur nga OSBE, Friedrich Ebert Stiftung, Qendra për Bashkëpunim Internacional në Maqedoni.

